



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I26-13 Prot.

Tiranë 18.12.2025

Nr. Dok. 202502578/13

Lënda: Rekomandohet marrja e masave me qëllim përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës në lagjen "Ish Pjeshkore", Bashkia Berat, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Drejtuar:

BASHKISË BERAT

KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar me iniciativë hetimin administrativ lidhur me problematikën e evidentuar nga media mbi problematikat serioze në lagjen "Ish-Pjeshkore" të qytetit Berat, e banuar nga rreth 150 familje të komunitetit rom. Informacioni fillestar është bërë publik nga organizata jofitimprurëse Community Reporters Albania (CRA), e cila ka evidentuar mungesën e investimeve publike dhe kushtet e vështira të jetesës në këtë lagje.

Në kuadër të këtij hetimi administrativ, me shkresë zyrtare AP iu drejtua Bashkisë Berat duke kërkuar informacion të detajuar lidhur me situatën e paraqitur dhe planifikimin e investimeve infrastrukturore në zonën "Ish-Pjeshkore", si dhe mbi rastet individuale për secilin nga ankuesit. Gjithashtu, u kërkuua vënia në dispozicion e çdo të dhëne apo dokumentacioni mbështetës që do t'i shërbente hetimit administrativ në fjalë.

Pas mungesës së përgjigjes në kërkesën e parë, Avokati i Popullit përsëriti kërkesën për sqarime. Vetëm pas dy shkresave të njëpasnjëshme, Bashkia e Beratit reagoi me shkresën nr. 380/1, datë 15.05.2025, në të cilën informoi në

mënyrë tepër të përgjithshme se në lagjen “Ish-Pjeshkore” “janë realizuar disa investime” si ndriçim publik, asfaltim dhe shtrimi i zhavorrit në disa segmente pa asfalt, si dhe vendosja e sinjalistikës rrugore. Po ashtu, bashkia theksonte se kjo lagje, njësoj si rajonet e tjera në territorin e Bashkisë Berat, “mbetet në konsideratë” për investime të mëtejshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve.

Megjithatë, përgjigja e sipërcituar e Bashkisë Berat u vlerësua e pamjaftueshme dhe joplotësuese për qëllimet e hetimit administrativ, për disa arsye kryesore: (1) Nuk u shoqërua me informacion të provueshëm mbi investimet – mungonin detaje mbi datat e kryerjes së tyre, vlerat e fondeve të shpenzuara, dokumentet tekniko-financiare ose fotografi të punimeve, çka do të nevojiteshin për të verifikuar realisht këto informacione. (2) Nuk u dha asnjë sqarim lidhur me moszbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, i cili parashikonte ndërhyrje konkrete për këtë zonë (rikonstruksion banesash dhe rrugë). Ky fakt ngre shqetësimin se mosrealizimi i planit mund të pasqyrojë një qasje diskriminuese institucionale ndaj këtij komuniteti. (3) U vu re mungesë transparence nga ana e autoriteteve vendore: Bashkia u përgjigj vetëm pas këmbënguljes me dy kërkesa, dhe përmbajtja e përgjigjes së saj - siç u sqarua më lart - mbeti tejet e përgjithshme dhe nuk ofroi prova konkrete për përmirësime reale në kushtet e jetesës së komunitetit. Në tërësi, komunikimi i cunguar dhe evaziv i pushtetit vendor në këtë rast cënon parimin e llogaridhënies publike dhe cenon të drejtën e informimit të qytetarëve për çështje me interes jetik.

Për shkak të sa më sipër, Avokati i Popullit e konsideroi të domosdoshëm thellimin e hetimit përtej korrespondencës me dokumente. Në këto kushte, u krye një verifikim në terren për të vëzhguar nga afër situatën faktike dhe për ta krahasuar me informacionet zyrtare të Bashkisë. Më datë 21 dhe 22 korrik 2025, në kuadër të “ditëve të hapura” të institucionit tonë në qytetin e Beratit, një grup pune i Avokatit të Popullit zhvilloi verifikime në lagjen “Ish-Pjeshkore”. Gjatë verifikimit në vend, u realizuan takime dhe intervista të drejtpërdrejta me banorë të komunitetit rom, të cilët paraqitën ankesat e tyre si grup dhe probleme individuale. Verifikimi në terren shërbeu njëkohësisht si përgjigje ndaj informacionit të dhënë nga Bashkia Berat, për të konfirmuar nëse investimet kishin ndikuar realisht në përmirësimin e kushteve.

Lagja “Ish-Pjeshkore” në Berat përbëhet nga një komunitet prej afro 150 familjesh rome, të cilat dallojnë qartë për mungesën e investimeve dhe

infrastrukturës bazë krahasuar me zonat e tjera urbane përreth. Banorët e kësaj lagjeje jetojnë në kushte të vështira, pa rrugë të shtruara, pa ndriçim publik dhe me kanalizime të improvizuara ose të munguara. Rruga kryesore dhe sheshet midis banesave janë kryesisht me baltë e zhavorr, pa asfaltim, duke e bërë të vështirë lëvizjen veçanërisht në kushte moti të keq. Shërbimet publike jetike mungojnë ose janë në gjendje të degraduar, dhe mbeturinat grumbullohen në mënyrë të pakontrolluar pranë banesave. Ky komunitet siguron të ardhura minimale për mbijetesë, kryesisht nga mbledhja e materialeve të riciklueshme, tregtia në kufijtë e informalitetit dhe lypja.

Konkretisht, situata paraqitet si vijon.

Banesat janë në kushte shumë të vështira. Disa prej tyre janë të ndërtuara me dru ose blloqe betoni të pambuluara, pa suva, me çati të improvizuara me llamarinë dhe plastikë. Disa struktura nuk plotësojnë kushtet minimale të sigurisë për banim dhe paraqesin rrezik për shembje. Brendësia e banesave tregon mungesë ventilimi, mungesë mobilimi bazë dhe kushte higjieno-sanitare shumë të dobëta.

Rrugët janë në gjendje të dëmtuar dhe të pashtuara. Rruga kryesore që përshkon lagjen është me zhavorr dhe baltë, pa asfaltim apo sinjalistikë të dukshme. Shumë prej shtigjeve ndërmjet banesave janë të ngushta, të paasfaltuara, me gjurmë të dukshme lagështire, mungesë kanalesh kullimi dhe mbeturina të shpërndara në hapësira publike.

Në disa raste, dhomat e banimit janë shumë të vogla, të mbingarkuara me objekte bazike dhe të përdorura për funksione të shumëfishta (gjumë, ngrënie, ruajtje sendesh). Dyshemetë janë të betonizuara në mënyrë primitive, dyshekët vendosen mbi to, dhe ndriçimi sigurohet përmes një llambë të varur në mënyrë të pasigurt nga tavani. Mungojnë sistemet bazike të ngrohjes dhe ajrosjes.

Nuk u konstatuan elementë funksionalë të ndriçimit publik, rrjeti i kanalizimeve ose mungon ose është i improvizuar, dhe mbeturinat grumbullohen në mënyrë të pakontrolluar, në hapësira të hapura apo pas gardheve të banesave. Në disa raste, oborret janë kthyer në hapësira grumbullimi për materiale plastike për riciklim, çka përbën rrezik për higjienën dhe shëndetin publik.

Banorët shprehën mosbesim ndaj premtimeve institucionale dhe theksuan mungesën e mbështetjes konkrete. Ata raportuan se nuk kanë përfituar asnjë nga ndërhyrjet e premtuara në Planin Lokal të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët. U theksua gjithashtu se ndërhyrjet publike janë selektive dhe nuk janë përqendruar në këtë zonë, ndryshe nga lagje të tjera përreth.

Gjendja e konstatuar në terren, mungesa e investimeve reale, niveli i lartë i varfërisë, kushtet e rrezikshme të banimit dhe mungesa e shërbimeve bazë tregojnë për një situatë që kërkon ndërhyrje urgjente dhe të koordinuar mes institucioneve.

Kuadri rregullator

Në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut cilësohen si *"të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme"*, duke u bërë bazë e rendit juridik të vendit tonë. Ky përcaktim sanksionon barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo problematikë ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës e rrjedhimisht të drejtën themelore të njeriut, të njohur si *"e drejta për jetën"*, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës. Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Neni 18 i Kushtetutës sanksionon se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për çfarëdo lloj arsye, përfshirë racën, etninë, gjuhën, statusin ekonomik etj., duke lejuar masa të veçanta mbrojtëse për grupe specifike kur ka shkaqe objektive. Kjo do të thotë se komuniteti rom në fjalë, si pakicë vulnerabël dhe në kushte të vështira ekonomike, ka të drejtë të trajtohet me kujdes të veçantë nga autoritetet, dhe çdo neglizhencë ndaj tyre mund të përbëjë diskriminim të tërthortë mbi bazë etnie apo statusi shoqëror. Kushtetuta njeh gjithashtu detyrime sociale të shtetit. Në nenin 59 (objektivat socialë) parashikohet detyrimi për *"plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim"* dhe standarde sa më të larta të kujdesit shëndetësor e mirëqenies. Edhe pse objektivat e nenit 59 nuk janë drejtpërdrejt të kërkueshme në rrugë gjyqësore, ato përbëjnë udhërrëfyes kushtetues për institucionet shtetërore që askush të mos lihet pa strehë dhe kushte minimale jetese. Më tej, Shqipëria është palë në instrumente ndërkombëtare si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i cili garanton të drejtën për një strehim të përshtatshëm dhe një nivel jetese të mjaftueshëm (neni 11). Ky pakt gëzon epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe zbatohet drejtpërdrejt. Mungesa e strehimit adekuat, e ujit të pijshëm dhe e energjisë cenon edhe të drejtën e jetës dhe shëndetit të banorëve – të drejta këto themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe konventat ku Shqipëria aderon.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe legjislacioni për decentralizimin u ngarkojnë bashkive përgjegjësi të qarta në fushën e shërbimeve komunitare dhe strehimit. Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të

luajë një rol më proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi¹. Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim efikas, aq edhe afër qytetarit. Në fakt, strehimi social është funksion i njësive të qeverisjes vendore si pjesë e kompetencave të tyre të veta.

Në rastin konkret, familjet rome të kësaj lagje praktikisht jetojnë të pastreha (ose në banesa të improvizuara jashtë çdo standardi), ndaj Bashkia duhet t'i trajtojë ata si familje në nevojë emergjente për strehim dhe t'i integrojë menjëherë në programet e strehimit social, përpara se situata të rëndohet më tej.

Po ashtu, aksesimi i shërbimeve bazë - si uji i pijshëm, energjia elektrike, kanalizimet, arsimi dhe shëndetësia - bën pjesë në funksionet dhe detyrimet e pushtetit vendor. Mungesa e këtyre shërbimeve për komunitetin rom në lagjen “ish Pjeshkore” është shkelje e parimit të barazisë në aksesin e shërbimeve publike. Sipas një studimi të PNUD, 38.8% e popullsisë rome në Shqipëri nuk ka ujë të rrjedhshëm në banesë dhe mbi 43% nuk kanë as banjë apo kanalizime, duke çuar në përhapjen e sëmundjeve infektive dhe mortalitet të lartë tek fëmijët². Ky realitet i hidhur kërkon ndërhyrje urgjente të autoriteteve lokale dhe qendrore për të siguruar furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbime higjieno-sanitare në këto komunitete.

Qeveria shqiptare ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025³, i cili është në fuqi dhe udhëzon institucionet në nivel qendror e lokal për përmirësimin e kushteve të këtyre komuniteteve. Ky plan kombëtar trajton me prioritet çështje si strehimi, punësimi, arsimi, kujdesi shëndetësor, regjistrimi civil dhe mbrojtja sociale, me objektiva specifike për mbylljen e hendekut mes romëve dhe pjesës tjetër të popullsisë. Në mënyrë të veçantë, plani thekson angazhimin e autoriteteve për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme strehimi dhe infrastrukture për komunitetet rome, përfshirë legalizimin e vendbanimeve informale aty ku është e mundur, ofrimin e banesave sociale, dhe garantimin e

¹ Ky parim në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet si: “...e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

² UNDP – Politikat dhe Praktikët e Strehimit të Romëve në Shqipëri – studim bazë, fq. 12

<https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Roma-Housing-.pdf#:~:text=baraka%20t%C3%AB%20improvizuara%2C%20pa%20akses,i%20personave%20q%C3%AB%20thon%C3%AB%20se>

³ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701 datë 18.11.2021;

aksesit në ujë, energji e shërbime higjienike. Bashkia Berat, si pjesë e pushtetit vendor, është aktore kyçe në zbatimin e këtij Plani Kombëtar. Siç është nënvizuar edhe nga vetë autoritetet shqiptare, ky plan synon garantimin e aksesit më të mirë në arsim, punësim dhe strehim për romët dhe egjiptianët, si dhe forcimin e zbatimit të ligjeve kundër diskriminimit⁴.

Rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare për trajtimin e pakicës rome

Republika e Shqipërisë është palë në traktatet kryesore ndërkombëtare që garantojnë të drejtat themelore të njeriut. Sipas nenit 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përbëjnë pjesë të rendit juridik të brendshëm dhe prevalojnë ndaj ligjeve vendore që bien ndesh me to. Ndër instrumentet përkatëse për këtë rast mund të përmenden si vijon.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR-DUDNJ), e cila në nenin 25 njeh të drejtën e çdokujt për një standard adekuat jetese, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, strehimin dhe kujdesin mjekësor, dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë apo gjendjet e tjera të mungesës së mjeteve të jetesës.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), ku neni 11 garanton të drejtën e çdokujt për një nivel jetese të mjaftueshëm për veten dhe familjen, përfshirë strehimin adekuat. Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Komiteti i CESCR) e ka interpretuar këtë nen në Komentet e përgjithshme nr. 4 dhe 7, duke theksuar se “*e drejta për strehim adekuat*” nuk nënkupton thjesht një çati mbi kokë, por kërkon kushte të përshtatshme jetese - akses në ujë të pastër, higjienë, energji, hapësirë të mjaftueshme, strukturë të sigurt fizike dhe mbrojtje ligjore ndaj dëbimeve të detyruara. Shtetet palë detyrohen të marrin masa pozitive për të eliminuar çdo diskriminim në realizimin e kësaj të drejte dhe t’u kushtojnë vëmendje të veçantë grupeve të cënueshme, si komunitetet rome, në politikat e strehimit.

Konventa Ndërkombëtare për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD) ndalon diskriminimin racor në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale e kulturore, përfshirë të drejtën e strehimit, shërbimeve publike dhe edukimit (neni 5). Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racor

⁴ UNITED NATIONS HUMAN RIGHTS COUNCIL Adoption of UPR Outcomes #HRC58 • 24 March 2025 <https://gchragd.org/ep-content/uploads/2025/02/Albania-UPR-Outcomes.pdf#:~:text=established%20targeted%20programmes%2C%20including%20the,with%20disabilities%20and%20improving%20the>

(CERD) ka nxjerrë udhëzime të posaçme (Rekomandimi i Përgjithshëm nr.27) mbi diskriminimin ndaj romëve, ku i kërkon shteteve të sigurojnë trajtim të barabartë të romëve në aksesin në banesa sociale, infrastrukturë dhe shërbime, dhe të parandalojnë segregimin e tyre në kushte nën-standarde të jetesës.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ECHR-KEDNJ), e ratifikuar nga Shqipëria, në nenin 14 ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa. Edhe pse KEDNJ nuk e parashikon shprehimisht të drejtën për strehim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka trajtuar raste lidhur me kushtet e jetesës së komuniteteve romë si çështje që lidhen me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare dhe banesës) dhe nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës, sidomos kur autoritetet dështojnë të ofrojnë infrastrukturën bazë dhe shërbimet ndaj këtyre komuniteteve.

Gjithashtu, Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar *Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, e cila kërkon nga shtetet të ndërmarrin politika aktive për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të pakicave, përfshirë romët, dhe të eliminojnë barrierat që pengojnë barazinë e plotë faktike të tyre në shoqëri.

Në bazë të këtyre akteve, shteti shqiptar – përfshirë organet e qeverisjes vendore – ka detyrimin jo vetëm të mos diskriminojë drejtpërdrejt ose tërthorazi komunitetet e pakicave, por edhe të marrë masa proaktive për t’u siguruar atyre një standard minimal jetese, strehimi të përshtatshëm dhe akses të barabartë në shërbime publike. Mospërmblidhja e këtyre detyrimeve mund të ngrejë përgjegjësi ndërkombëtare për shtetin dhe jep të drejtën për mjete ligjore efektive individëve të prekur.

Në kuadër të angazhimeve të marrë në këto instrumente, Shqipëria i nënshtrohet monitorimit periodik nga organizma ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut. Ato kanë adresuar vazhdimisht gjendjen e komunitetit rom në Shqipëri, duke bërë thirrje për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre dhe eliminimin e diskriminimit institucional.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) – organ monitorues i Këshillit të Evropës – ka evidentuar vazhdimisht vështirësitë ekstreme të komunitetit rom në strehim dhe u ka rekomanduar autoriteteve shqiptare masa të forta. Në raportin e tij të fundit, ECRI vëren se “*situata e strehimit është ende jashtëzakonisht e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë*

*në Shqipëri. Përveç kushteve shumë të këqija të banimit, mungesa e gjerë e titujve të pronësisë ose kontratave të sigurta i bën pjesëtarët e këtij komuniteti të cenueshëm ndaj dëbimeve*⁵. Ky vlerësim duket sikur përshkruan pikërisht rastin e komunitetit në lagjen “ish-Pjeshkore”, që jeton në kushte të mjerueshme dhe pa status të qartë pronësie. ECRI i ka rekomanduar autoriteteve shqiptare: (i) të shtojnë përpjekjet për të legalizuar banesat informale ku banojnë romët, (ii) të sigurojnë që çdo dëbim i mundshëm të kryhet vetëm duke respektuar plotësisht garancitë ndërkombëtare (njoftim i hershëm, mbrojtje ligjore efektive, dhe ofrimi i strehimit alternativ), dhe (iii) të garantohet prioritet për romët e prekur nga prishja e banesave në programet e strehimit social.

Edhe organet e OKB-së kanë bërë thirrje për veprime. Komiteti i OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR), në konkluzionet përmbledhëse të shqyrtimit të raportit të katërt periodik të Shqipërisë, në shtator 2024⁶, shpreh shqetësim të veçantë për gjendjen e komuniteteve romë dhe egjiptiane në vend. Komiteti vlerëson miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve (2021-2025), por thekson se këto komunitete vazhdojnë të përballen me diskriminim të përhapur shoqëror dhe përjashtim socio-ekonomik, përfshirë akses të kufizuar në punësim, shërbim shëndetësor, arsim dhe në një standard të përshtatshëm jetese. Një shqetësim i veçantë është mungesa e të dhënave të ndara për romët dhe egjiptianët, çka pengon hartimin e politikave të drejtuara dhe efektive. Komiteti i rekomandon Shqipërisë:

- *Të forcojë masat kundër diskriminimit dhe përjashtimit socio-ekonomik të romëve dhe egjiptianëve, me fokus në aksesin e barabartë në punë, shëndetësi, arsim dhe standard të jetesës, veçanërisht për gratë dhe vajzat;*
- *Sigurojë zbatimin efektiv të Planit Kombëtar dhe të politikave përkatëse për këtë komunitet, përmes monitorimit të rregullt dhe alokimit të burimeve të mjaftueshme;*
- *Grumbullojë të dhëna të ndara për romët dhe egjiptianët në mënyrë të respektueshme dhe me vetëidentifikim, për të adresuar në mënyrë të saktë nevojat dhe pengesat që hasin në ushtrimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore;*

⁵ ECRI REPORT ON ALBANIA (sixth monitoring cycle), fq.2,

<https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241#:~:text=Housing%2053,on%20unused%20public%20land%20but>

⁶ United Nations E/C.12/ALB/CO/4 Committee on Economic, Social and Cultural Rights Concluding observations on the fourth periodic report of Albania

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/SessionDetails1.aspx?SessionID=2686&Lang=en

- *Të udhëhiqet nga Komenti i Përgjithshëm nr. 20 (2009) mbi mosdiskriminimin në ushtrimin e të drejtave të përfshira në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁷.

Edhe Komiteti i OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD), shpreh shqetësim të thellë për diskriminimin e vazhdueshëm dhe përjashtimin social që përjetojnë komunitetet romë dhe egjiptiane në Shqipëri. Në përfundimet për shqyrtimin e raportit të 13-të dhe 14-të periodik të Shqipërisë (prill 2024)⁸, janë adresuar disa problematika që lidhen drejtpërdrejt me situatën e komunitetit rom në lagjen “ish-Pjeshkore” në Berat. Komiteti shpreh shqetësim të vazhdueshëm për diskriminimin strukturor dhe të përhapur ndaj komunitetit rom dhe atij egjiptian, përfshirë marginalizimin social që kufizon mundësinë e tyre për të përfituar të drejtat sipas Konventës për Eliminimin e Diskriminimit Racor. Në veçanti, rekomandohet që Shqipëria të përmirësojë aksesin në strehim adekuat, furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, si dhe të garantojë sigurinë e pronësisë dhe mbrojtjen nga dëbimet e detyruara, përmes konsultimit real me komunitetet e prekura. Gjithashtu, Komiteti thekson domosdoshmërinë për zbatimin efektiv të Planit Kombëtar për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përmes alokimit të burimeve të mjaftueshme financiare, teknike dhe njerëzore, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të komunitetit në çdo fazë të zbatimit. CERD shpreh shqetësim për aksesin e kufizuar në shërbimet publike dhe mungesën e dokumentacionit civil, si dhe për hendekun digjital që pengon përfshirjen e plotë të këtij komuniteti në shoqëri. Rekomandohet që të ndërmerren masa për pajisjen me dokumente identifikimi dhe për të garantuar barazi në qasjen ndaj shërbimeve publike. Në mënyrë të veçantë, vlerësohet e nevojshme që autoritetet vendore të intensifikojnë përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke e parë këtë si një mekanizëm kyç për mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të njeriut në nivel lokal. Këto rekomandime, në kontekstin e rastit të komunitetit në lagjen “ish-Pjeshkore”, nënvizojnë

⁷ Komenti i Përgjithshëm nr. 20 i Komitetit të OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR), miratuar në sesionin e 42-të në maj 2009, saktëson përmbajtjen dhe shtrirjen e nenit 2, paragrafi 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Ky komentim thekson se ndalimi i diskriminimit është një përbërës themelor i zbatimit të të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë diskriminimin mbi bazën e racës, përkatësisë etnike, gjinisë, gjuhës, statusit socio-ekonomik apo çdo karakteristike tjetër të mbrojtur.

⁸ United Nations CERD/C/ALB/CO/13-14, International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, Committee on the Elimination of Racial Discrimination, Concluding observations on the combined thirteenth and fourteenth periodic reports of Albania, <https://docs.un.org/en/CERD/C/ALB/CO/13-14>

detyrimin e autoriteteve vendore për të siguruar kushte jetese që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe ndalojnë çdo formë diskriminimi të tërthortë apo të drejtpërdrejtë.

Po ashtu, procesi i Rishikimit Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë ka prodhuar rekomandime të posaçme për komunitetin rom. Gjatë ciklit të tretë të UPR (2019), u adresua edhe nevoja e përmirësimit të kushteve të jetesës për romët. Shqipëria pranoi, ndër të tjera, rekomandime për investime në strehim social dhe sigurimin e shërbimeve thelbësore për komunitetet rome. Këto angazhime ndërkombëtare shtojnë peshën e detyrimit që Bashkia Berat (dhe institucionet e tjera përgjegjëse) të veprojnë me përgjegjshmëri dhe në përputhje me standardet më të larta për këtë çështje⁹. Në procesin e fundit UPR në vitin 2024 disa shtete kanë adresuar rekomandime të posaçme lidhur me trajtimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane, me theks të veçantë në eliminimin e diskriminimit dhe përfshirjen e tyre të barabartë në shërbimet publike¹⁰. Të gjitha këto rekomandime janë pranuar dhe mbështetur nga shteti shqiptar, çka nënkupton se Shqipëria është zotuar formalisht për t'i zbatuar ato, duke marrë përsipër përgjegjësinë për të garantuar barazi reale dhe mbrojtje efektive të të drejtave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në përputhje me angazhimet e saj ndërkombëtare për të drejtat e njeriut¹¹. Pranimi i këtyre rekomandimeve nga qeveria shqiptare nënkupton detyrimin për t'i zbatuar ato, pra për t'u siguruar që çdo anëtar i komunitetit në lagjen “ish-Pjeshkore” të pajiset me dokumente identiteti dhe të regjistrohet ligjërisht si banor, në mënyrë që të përfitojë nga shërbimet.

⁹ Universal Periodic Review – Albania, <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/al-index>

¹⁰ Rekomandimi 124.227 (nga Kili): “Të luftohen diskriminimi dhe dhuna ndaj pakicave rome dhe egjiptiane.” Rekomandimi 124.228 (nga Kolumbia): “Të eliminohet çdo formë diskriminimi që vazhdon ndaj pakicave etnike, në veçanti për djemtë dhe vajzat rome, dhe të garantohet arsimi gjithëpërfshirës parashkollor për të gjithë fëmijët pa diskriminim.”

Rekomandimi 124.229 (nga Bjellorusia): “Të ndërmerren masa shtesë për eliminimin e diskriminimit ndaj pakicave kombëtare, përfshirë komunitetin rom.”

Rekomandimi 124.230 (nga Sri Lanka): “Të zbatohen reformat e nevojshme për të eliminuar çdo formë diskriminimi ndaj komunitetit rom dhe pakicave të tjera etnike.”

Rekomandimi 124.226 (nga Australia): “Të zbatohet plotësisht Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve, për të ulur nivelin e braktisjes shkollore mes këtyre komuniteteve.”

¹¹ Universal Periodic Review 47th Session 4th Cycle November 2024 ALBANIA Tirana Legal Aid Society Roma Active Albania European Network on Statelessness 8 April 2024, fq.2:

https://upr-info.org/sites/default/files/country-document/2025-04/JS1_UPR47_Albania.pdf#:~:text=2%20During%20the%20first%20cycle%2C,in%20Albania%2C%E2%80%9D%203%20hile%201

Pas verifikimeve të kryera në terren dhe shqyrtimit të informacionit të mbledhur, rezulton se gjendja faktike e komunitetit rom në lagjen “Ish-Pjeshkore” tregon një mospërmbushje serioze të detyrimeve institucionale ndaj këtij komuniteti. Më poshtë paraqiten gjetjet kryesore nga verifikimi i korrikut 2025, të krahasuara me standardet ligjore dhe ato administrative.

Rruga kryesore e lagjes “Ish-Pjeshkore” në Berat, është e paasfaltuar dhe pa ndriçim publik. Infrastruktura rrugore është në gjendje të degraduar, me sipërfaqe të mbuluar nga pluhuri dhe balta, duke reflektuar mungesën e investimeve publike në këtë komunitet. Gjatë verifikimit u konstatua se infrastruktura rrugore e lagjes është pothuajse tërësisht e amortizuar. Rrugët kryesore dhe dytësore janë të paasfaltuara; në shumë segmente haset vetëm zhavorr i hedhur dikur ose dhe’ i ngjeshur, i cili në mot të lagësht kthehet në baltë. Mungon drenazhi (kanalet e ujërave) anësor, çka bën që ujërat e shirave të qarkullojnë lirisht nëpër rrugica ose të ngecin në pellgje balte. Ndriçimi publik mungon thuajse tërësisht – gjatë vizitës u vërejtën shumë pak shtylla ndriçimi dhe asnjë prej tyre funksionale, gjë që e zhyt lagjen në errësirë totale gjatë natës. Sinjalistika rrugore apo tabela me emërtimin e rrugëve ishin inekzistente. Kjo gjendje jo vetëm vështirëson lëvizjen e përditshme të banorëve (sidomos të fëmijëve, të moshuarve apo personave me aftësi të kufizuara), por krijon dhe rreziqe për shëndetin e tyre, si rrëshqitje apo dëmtime fizike, si dhe i ekspozon ata ndaj pasojave të izolimit social (në mungesë të ndriçimit, lëvizja e lirë pas perëndimit bëhet e pasigurt).

Në mjediset e jashtme të lagjes “Ish-Pjeshkore” u vërejtën mbeturina plastike dhe materiale të riciklueshme grumbulluar pas një gardhi të improvizuar, ndërsa në sfond duken banesa të ndërtuara me blloqe betoni pa suvatuar dhe çati të pajisura me llamarina të vjetra. Këto kushte të mjedisit reflektojnë nivelin e ulët të shërbimeve publike (mungesë e pastrimit dhe e sistemeve të kanalizimit) në këtë komunitet. Situata e banesave dhe mjedisit përreth tyre është alarmante. Shumë shtëpi janë ndërtuar prej vetë banorëve në mënyrë informale, me materiale të dobëta dhe pa standarde ndërtimore. U identifikuan struktura të ngritura me trarë druri, dërrasa, blloqe betoni të pa suvatosur, plastmasë dhe llamarina të ndryshkura për çati. Muret e banesave, në mungesë të izolimit, lejojnë depërtimin e lagështirës dhe të të ftohtit gjatë dimrit; po ashtu, në verë, banesat janë të ekspozuara ndaj nxehtësisë së lartë për shkak të mungesës së termoizolimit. Disa shtëpi janë në rrezik shembjeje – u vunë re plasaritje serioze strukturore dhe shtylla mbajtëse të improvizuara për të mos lejuar kolapsin.

Brenda banesave, kushtet higjiëno-sanitare janë shumë larg standardeve minimale. Familje prej 5-6 anëtarësh jetojnë në një ambient të vetëm (një

dhomë) që u shërben njëkohësisht si dhomë gjumi, kuzhinë dhe depo, për shkak të mungesës së hapësirës. Dyshemetë janë kryesisht me beton ose dhe', pa shtrim dhe pa izolim; shumë banorë flenë mbi dyshekë të vendosur direkt në dysheme. Mobiliet bazike mungojnë ose janë tepër të pakta – u konstatuan raste ku një dollap i vogël përdorej për të gjithë familjen, dhe ku shpesh gjërat personale vareshin nëpër mure ose vendoseshin në kuti plastike. Ndriçimi i brendshëm kufizohet shpesh në një llambë elektrike të varur nga tavani me lidhje të pasigurt kabujsh. Në shumicën e banesave mungon një sistem ngrohjeje – në dimër familjet ngrohen me mjete rrethanore (si soba druri të improvizuara), që përbëjnë rrezik zjarri dhe ndotin ajrin e brendshëm. Po ashtu, ventilimi është i pamjaftueshëm, për shkak se dritaret janë të vogla ose mungojnë krejtësisht në disa godina. Këto kushte favorizojnë përhapjen e mykut, lagështirës dhe sëmundjeve respiratore, sidomos te fëmijët e vegjël.

Kushtet sanitare janë veçanërisht problematike. Vetëm pak banesa kanë tualet brenda mureve; shumica përdorin tualete të jashtme primitive ose kanë përshtatur kënde brenda barakave me perde ose llamarina, pa ujë të rrjedhshëm e pa kanalizim të mbyllur. Uji i pijshëm merret nga një çezmë publike në hyrje të lagjes ose nga depozita uji që mbushen periodikisht. Mbetjet e ujërave të zeza derdhen nëpër hendeqe a gropa septike të hapura, çka krijon rrezik epidemiologjik. Gjithashtu, mbetjet urbane (plehrat) nuk mblidhen rregullisht nga ndërmarrja komunale; gjatë verifikimit u panë grumbuj mbeturinash (kryesisht plastikë, kanaçe, dhe materiale të tjera recicluese që banorët i mbledhin) në skajet e rrugëve apo pas gardheve. Kjo gjendje, përveçse dëmton mjedisin, tërheq insekte dhe brejtës, duke rritur rrezikun për sëmundje infektive në komunitet.

Banorët romë të lagjes “Ish-Pjeshkore” i kanë shprehur hapur përfaqësuesve tanë zhgënjimin dhe mosbesimin e tyre ndaj premtimeve institucionale. Ata pohuan se, pavarësisht se në letër ekziston një plan lokal veprimi për ta, në realitet ata nuk kanë përfituar asnjë nga ndërhyrjet e premtuara në kuadër të atij plani. Banorët theksuan se ndërhyrjet publike në qytetin e Beratit duket se bëhen në mënyrë selektive – *“zona jonë as që merret parasysh”*, u shpreh një prej tyre – ndërsa lagjet e tjera kanë përfituar investime të konsiderueshme vitet e fundit. Disa prej banorëve ngritën pretendimin se shkak për këtë neglizhencë mund të jetë diskriminimi i hapur: *“Sepse jemi romë, na trajtojnë si njerëz të dorës së dytë”*, thanë ata, duke kërkuar që institucionet të dëshmojnë me vepra të kundërtën.

Nga vlerësimi i përgjithshëm, del qartë se gjendja e konstatuar në terren nuk përputhet me deklaratimet e Bashkisë Berat se janë kryer investime dhe se situata

po përmirësohet. Përkundrazi, realiteti i lagjes “Ish-Pjeshkore” dëshmon mungesë të investimeve thelbësore dhe kujdesit institucional. Kushtet e jetesës aty janë nën standardet minimale njerëzore, çka përbën cenim të dinjitetit dhe të drejtave bazë të banorëve. Kjo situatë përbën shkelje të detyrimeve ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila sipas ligjit ka për detyrë të sigurojë shërbimet publike bazë për çdo komunitet nën juridiksionin e saj.

Për më tepër, situata aktuale rrezikon të sjellë shkelje të një sërë të drejtash të njeriut të mbrojtura ndërkombëtarisht. E drejta për strehim adekuat dhe për një nivel jetese të pranueshëm (neni 11 i CESCRR) nuk është duke u realizuar për këta banorë; Komiteti i CESCRR do ta konsideronte këtë një shembull të dështimit në detyrimin e shtetit “për të marrë masa të duhura” drejt realizimit progresiv të kësaj të drejte. Po ashtu, e drejta për shëndet dhe mirëqenie (neni 12 i CESCRR) cenohet nga mungesa e ujit të pijshëm, higjienës dhe kushteve sanitare. Situata mund të përbëjë edhe trajtim çnjerëzor në kuptim të nenit 3 të KEDNJ nëse neglizhohet më tej, nisur nga standardet e GJEDNJ mbi kushtet e jetesës së grupeve vulnerabël. Në këtë aspekt, rekomandimet ndërkombëtare të cituara më lart marrin një peshë edhe më të madhe – Shqipëria rrezikon të gjendet në shkelje të angazhimeve të saj ndërkombëtare nëse nuk adreson me urgjencë këtë situatë.

Nga ana tjetër, krahas verifikimit në terren, Avokati i Popullit trajtoi në mënyrë individuale edhe ankesat e administruara drejtpërdrejt nga qytetarët.

Konkretisht, bëhet fjalë për rreth 150 familje, të cilat paraqitën ankesat e tyre, lidhur me kushtet e papërshtatshme të strehimit dhe varfërinë e tejskajshme. Avokati i Popullit i ka drejtuar kërkesa të përsëritura për shpjegime Bashkisë Berat në lidhje me kushtet social ekonomike, si dhe me masat që mund të ndërmerren si nga Bashkia ashtu dhe nga institucionet e tjera në nivel vendor, për të ndihmuar këto familje.

Gjatë këtij hetimit administrativ, rezultoi se problematika e përbashkët që shfaqin të gjithë këto familje ishte e njëjtë, konkretisht; probleme social-ekonomike, strehim i papërshtatshëm, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, kushte të papërshtatshme infrastrukturore etj., lidhur kjo ndër të tjera edhe me faktin se këta qytetarë nuk arrijnë t’i drejtohen institucioneve vendore për të kërkuar mbështetje, për shkak të nivelit të ulët arsimor dhe mungesës së ndihmës juridike për pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e mbrojtjes sociale.

Bashkia Berat, me shkresën nr. 5457/1, dt. 29.10.2025 informon se:

*“është në dijeni të problemit të strehimit që këta banorë kanë. Nga verifikimi në vend i gjendjes aktuale të strehimit rezulton se këta banorë jetojnë në zonën e ish-Pjeshkores në ambiente të përbëra nga një dhomë e vetme pa tualet të ndërtuara me mur blloku, plithare (kallam+balte), konteniere dhe që nuk kanë aplikuar pranë ASHK-së Berat për legalizim të tyre. Nga ana jonë ju bë me dije se nëse nuk futen në procedurën e legalizimit këta banorë nuk mund të trajtohen me projektin "Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë projekt i cili po zbatohet nga Bashkia Berat që nga viti 2020, ku një numër i konsiderueshëm i familjeve të trajtuara i përkasin Komunitetit Rom. Ju theksua se specialistët tanë të zyrës me një ndalesë do ti ndihmojmë me asistencën e tyre për të aplikuar në portalin e-albania për "Kërkesë për t'u trajtuar me programet e strehimit social" si dhe aplikimin në sistemin e ASHK-së për legalizim të ambienteve të banimit që kanë në përdorim. Kjo nuk është hera e parë që këta qytetarë nga ana jonë, janë informuar dhe adresuar në zyrat përkatëse për tu paraqitur dhe dhënë zgjidhje problematikës së tyre të strehimit, por nga ana e tyre në moment na thonë mirë do paraqitemi dhe në përfundim këta neglizhojmë duke u mosparaqitur Ky është një problem që nuk mund të zgjidhet i vetëm nga Bashkia, pa angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre dhe të institucioni të Ashk-së Berat pasi ka edhe një kosto financiare për gjithë secilin. z. ** është bërë pjesë e projektit të vitit 2025 që po zbatohet tani, ndërsa z. *** do të trajtohet me projektin e 2026, pasi ky qytetar kishte aplikuar pranë ASHK-së Berat "Për legalizim të banesës".”*

Nga ana tjetër, hetimi administrativ nxjerr në pah se komuniteti rom i lagjes “Ish-Pjeshkore” në Berat ndodhet në një situatë të papranueshme socio-ekonomike, e karakterizuar nga mungesa e infrastrukturës bazë, kushtet e rënda të banimit dhe mungesa e shërbimeve publike jetike. Këto mangësi nuk janë thjesht çështje zhvillimi apo ekonomike, por ngërthejnë dimensione të qarta të të drejtave të njeriut.

Njësia e vetqeverisjes vendore ka detyrimin të luajë një rol proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi¹².

¹² Ky parim në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet si: “...e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim efikas, afër qytetarit. Ky rol e mision i Bashkisë si organ i qeverisjes vendore shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kriterëve politike që Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social-ekonomike, ku përfshihen si subjekte edhe minoritetet kombëtare në vend.

Për shkak të mungesës së zhvillimit në këto komunitete, puna për ta duhet të jetë intensive dhe e vazhdueshme që të arrihet trajtimi i barabartë dhe adresimi i problematikave me të cilat përballen ky komunitet. Përpjekjet për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave duhet të jenë ndërinstitutionale, pasi problemi është strukturor dhe sistemik.

Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet dhe angazhimin e deritanishëm të Bashkisë Berat, si dhe informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë në kuadër të këtij hetimi administrativ, por thekson se standardi që kërkohet nga praktikat bashkëkohore dhe detyrimet ndërkombëtare nuk kufizohet te dokumentimi i investimeve, por shtrihet te provat e impaktit real mbi jetën e komunitetit: *a kanë sot familjet e komunitetit rom në Baltëz ujë të pijshëm të sigurt dhe presion të mjaftueshëm? funksionojnë kanalizimet? a është ndriçuar realisht rrjeti i rrugicave ku banojnë rreth 150 familje?* Këto janë tregues rezultati që duhen provuar, në përputhje me udhëzuesin e OKB-së për indikatorët e të drejtave të njeriut¹³, që kërkon matje *input-proces-output-outcome/impact*) dhe me përkufizimin e CESC¹⁴ për “*strehimin adekuat*”, i cili përfshin akses të qëndrueshëm në ujë të pijshëm, energji dhe higjienë si elemente thelbësore të së drejtës për një standard jetese të mjaftueshëm.

Në këtë kuptim, përse problematika vijon të adresohet nga komuniteti, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, masat e ndërmarra derimëtanë rezultojnë të jenë të pamjaftueshme dhe të mbartura në kohë.

Në rastin e banorëve të Lagjes “ish Pjeshkore”, Avokati i Popullit identifikon disa aspekte thelbësore që e bëjnë përmirësimin e kushteve të strehimit dhe kushteve të përgjithshme të jetesës së këtyre banorëve, në një kohë sa më të shpejtë, një prioritet kyç.

¹³ Human Rights Indicators: A Guide for Measurement and Implementation, shih: <https://www.ohchr.org/en/publications/policy-and-methodological-publications/human-rights-indicators-guide-measurement-and>

¹⁴ CESCR General Comment No. 4: The Right to Adequate Housing,

shih: <https://www.globalhealthrights.org/instrument/cescr-general-comment-no-4-the-right-to-adequate-housing/>

Së pari, ndërhyrjet në kohë dhe të vazhdueshme me qëllim adresimin e problemit të strehimit nëpërmjet programeve të strehimit social, ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të përgjithshëm të anëtarëve të këtij komuniteti. Ndërgjegjësimi dhe ndihma juridike ndaj ketyre qytetarëve për të mundësuar aksesueshmërinë në shërbimet sociale, është një çështje kyçe për mirëqenien e banorëve dhe ky aspekt i rëndësishëm kërkon një përqasje të përshtatshme nga Bashkia.

Se dyti, hartimi i projekteve që adresojnë këto sfida nga Bashkia duhet të sigurojnë që ndërhyrja të jetë e shpejtë, efektive dhe e qëndrueshme. Gjendja e krijuar me komunitetin Rom në lagjen “ish Pjeshkore”, identifikon nevojën e mbështetjes emergjente, por dhe të vazhdueshme e të përhershme, nëpërmjet marrjes së masave të shpejta dhe efikase, për krijimin e kushteve normale të jetesës, me qëllim arritjen e standardeve më të larta të integritetit të qytetarëve të këtij komuniteti nga ana e organeve me kompetenca ekzekutive dhe përfaqësuese, të Bashkisë Berat.

Përkushtimi i organeve të qeverisjes vendore për të adresuar konkretisht nevojat emergjente të banorëve, anëtare të këtyre komuniteteve, nuk reflektohet vetëm me ekzistencën e këtyre planeve vendore, por mbi të gjitha duke siguruar zbatimin e tyre në tërësi dhe në një kohë sa më të shpejtë. Kjo siguron që angazhimi për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të mos jetë vetëm një koncept, por të kthehet në ndryshim konkret dhe të qëndrueshëm në realitetin lokal.

Përmes zbatimit të dokumentave strategjikë në nivel vendor, me afate konkrete, krijohet një rrugë e qartë për të arritur qëllimet e strategjisë kombëtare dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e veprimeve në nivel vendor.

Avokati i Popullit vlerëson se Bashkia Berat duhet të ndërmarrë hapa konkretë dhe urgjentë për realizimin e angazhimeve të parashikuara në planin lokal.

Konkretisht, së pari nevojitet të merren masa për sa vijon.

Rikonstruksioni i banesave të dëmtuara. Të identifikohen familjet me banesat në gjendjen më kritike dhe, brenda një afati të sa më të shpejtë, të nisë rehabilitimi i atyre banesave (ndryshim çatie, suvatim muresh, vendosje dyer-dritare të reja, instalime sanitare ku mungojnë, etj.). Prioritet t’u jepet masave për 20 banesat e

parashikuara edhe në plan¹⁵, por pa u kufizuar vetëm në to, nëse nevojat reale janë më të mëdha.

Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore. Të fillojë me prioritet, punimet për përmirësimin e rrugëve të brendshme të lagjes, si dhe të vendoset sinjalistika e nevojshme dhe emërtimi zyrtar i rrugëve, për t'i integruar këto hapësira në hartën urbane të qytetit.

Ndriçimi publik. Nevojitet të instalohet rrjeti i ndriçimit publik në lagje brenda një afati shumë të afërt. Deri sa të realizohet plotësisht projekti i ndriçimit, të merren masa të përkohshme për të eliminuar errësirën totale gjatë natës.

Ujësjiellës-kanalizime dhe menaxhimi i mbetjeve. Të kryhet një vlerësim teknik i nevojave për furnizim me ujë dhe kanalizime në lagje. Nëse lagjja mund të lidhet me rrjetin ekzistues urban, të merret masa menjëherë për shtrirjen e linjave të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve deri aty. Paralelisht, të vendosen kontenierë për mbeturinat në pika të përshtatshme dhe të organizohet grumbullimi periodik i mbetjeve nga shërbimet komunale. Pastrimi i ambientit të brendshëm të lagjes duhet trajtuar me përparësi, duke eliminuar grumbujt ekzistues të mbeturinave dhe duke dezinfektuar zonat e ndotura.

Masat afatgjata për strehimin. Bashkia duhet të synojë që familjet rome të “Ish-Pjeshkore” të përfitojnë nga programet e strehimit social (bonus qiraje, banesa sociale, etj.) në proporcion të drejtë me nevojat e tyre, duke i ofruar ndihmën e nevojshme ligjore dhe asistencë për aplikimet përkatëse.

Së dyti, Avokati i Popullit vlerëson se një nga aspektet më të rëndësishme të zbatimit të politikave sociale, është edhe vlerësimi i impaktit apo i ndikimit të këtyre politikave tek qytetarët, duke vlerësuar në mënyrë të qartë barazinë në shërbime (p.sh. përqindja e rrugëve të asfaltuara, e familjeve me akses në ujë/kanalizim, etj.) dhe këta tregues të ndiqen në mënyrë periodike. Nëse treguesit rezultojnë shumë më të ulët në lagjet me shumicë rome, atëherë buxheti dhe programet vjetore të investimeve duhet të adresojnë posaçërisht ato mungesa.

Së treti, është e nevojshme që Bashkia Berat të angazhohet në një dialog transparent dhe të rregullt si me banorët e “Ish-Pjeshkore”-s, ashtu edhe me

¹⁵ Sipas planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili (2022-2025) të Bashkisë Berat, f.14, *Janë 20 familje të cilat kanë nevojë për nderhyrje emergjente për rikonstrukcion. Kjo zonë ka probleme me ndricimin rrugor si dhe me mungesën e energjisë elektrike në disa banesa.*

institucionin e Avokatit të Popullit dhe aktorë të tjerë në nivel vendor dhe qendror. Këto takime duhet të jenë konkrete, ku të paraqiten plane pune, afate dhe të merren opinionet e komunitetit për prioritetet.

Duke qenë se sfidat e evidentuara në “Ish-Pjeshkore” lidhen edhe me kapacitete financiare e teknike, rekomandohet që Bashkia Berat t’i drejtohet qeverisë qendrore për mbështetje dhe të koordinojë veprimet me të.

Avokati i Popullit beson se zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e ndjeshëm të jetës së banorëve të “Ish-Pjeshkore”-s dhe në rikthimin e besimit të tyre te institucionet publike. Këto masa do të përmbushnin jo vetëm detyrimet ligjore vendase, por edhe do të ishin në harmoni me praktikrat dhe standardet më të mira ndërkombëtare për trajtimin e komuniteteve romë, ashtu siç kërkohet nga organizmat përkatës. Avokati i Popullit do të qëndrojë i angazhuar në ndjekjen e mëtejshme të kësaj çështjeje deri në përmbushjen e plotë të të drejtave të komunitetit në fjalë.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jetese më të mirë për anëtarët e komunitetit Rom, në lagjen “ish Pjeshkore”, Berat, bazuar në:

- Nenin 1, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku thuhet shprehimisht se: *“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”*;
- Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*;
- Në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:
paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*.

REKOMANDOJMË

- ✓ *Vijimin dhe intensifikimin e ushtrimit të plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Berat dhe strukturave vendore në varësi të saj, për një vlerësim të plotë e gjithëpërfshirës, me qëllim përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës në lagjen “ish Pjeshkore” në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.*

- ✓ *Vijimin dhe intensifikimin e angazhimit të Bashkisë Berat në hartimin dhe zbatimin e programeve konkrete të ndërhyrjes dhe projekteve investuese për lagjen “ish Pjeshkore”, për përmirësimin e kushteve të banimit, rehabilitimin ose sistemimin e banesave nën standard, infrastrukturën, si dhe për zgjerimin e rrjetit të shërbimeve sociale, duke iu drejtuar qeverisë qendrore për mbështetje financiare dhe teknike, dhe duke koordinuar në mënyrë të vazhdueshme veprimet me të, me qëllim sigurimin e një përgjigjeje të integruar institucionale për garantimin e të drejtës për strehim dhe jetesë dinjitoze.*
- ✓ *Marrja e masave për të kryer një vlerësim të impaktit apo ndikimit të këtyre masave apo politikave tek qytetarët, banorë të kësaj lagjeje, për të garantuar në mënyrë të qartë barazinë në shërbime.*
- ✓ *Marrja e masave për zhvillimin dhe zbatimin e fushatave intensive për ndërgjegjësimin e komunitetit lidhur me përfitimin nga programet sociale të strehimit, të ndihmës sociale, punësimit e shërbimeve të tjera që ofrohen në nivel vendor.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

DV